



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

6866/6
Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 28.10.2025

URDHËR

Nr. 555, datë 28.10.2025

PËR

MIRATIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE TË DISA LËNDËVE TË
KURRIKULËS BËRTHAMË, TË DISA KLASAVE TË ARSIMIT BAZË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 45 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjave “dh” dhe “e”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.09.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Orjana Osmani”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Gjuhë angleze”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Qytetari”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Matematikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
4. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Dituri natyre”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
5. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Edukim fizik, sport dhe shëndet”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

6. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Muzikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor", sipas shtojcës 6, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
7. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Art pamor", të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor", sipas shtojcës 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
8. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Teatër", të kurrikulës bërthamë, për klasën e pestë, klasën e gjashtë dhe klasën e shtatë të arsimit bazë", sipas shtojcës 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
9. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë shqipe", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 9, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
10. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë angleze", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 10, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
11. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës "Qytetari", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 11, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
12. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Histori", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 12, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
13. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjeografi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 13, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
14. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Matematikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 14, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
15. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Fizikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 15, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
16. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Biologji", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 16, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
17. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 17, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
18. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë (frënge, italiane, gjermane), për shkollat me marrëveshje me ambasadat", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 18, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
19. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë dhe klasën e shtatë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 19, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

20. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Muzikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët”, sipas shtojcës 20, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
21. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Art pamor”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët”, sipas shtojcës 21, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
22. Programet mësimore të klasës së parë dhe klasës së gjashtë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2026 – 2027.
23. Programet mësimore të klasës së shtatë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2027 – 2028.
24. Programi mësimor i klasës së pestë hyn në fuqi dhe fillon zbatimin në vitin shkollor 2029 – 2030.
25. Programet mësimore të mëparshme, shfuqizohen sipas fillimit të zbatimit të programeve mësimore të lëndëve në klasat e sipërcituara.
26. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



PROGRAMI I LËNDËS “ART PAMOR” ARSIMI I MESEM I ULËT KLASA 6

FUSHA “ARTET”

PROGRAM I PËRDITËSUAR

Koordinator: Marina Topulli



PËRMBAJTJA

1	HYRJE.....	5
2	QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS	6
	2.1 Objektivat e përgjithshme të artit pamor në arsimin e mesëm të ulët	6
3	PËRMBAJTJA E PROGRAMIT	7
4	KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA E ARTIT PAMOR	10
	4.1 Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit.....	10
	4.2 Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e artit pamor	15
	4.3 Kompetencat e lëndës së artit pamor dhe rezultatet e të nxënit	16
5	PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	21
	5.1 Koha mësimore për secilën tematikë për klasën e gjashtë	21
	5.2 Përmbajtja e lëndës sipas tematikave dhe përshkrimi i përmbledhur i tyre	22
	5.2.1 Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik	23
	5.2.2 Tematika: Teknika dhe procese artistike	27
	5.2.3 Tematika: Historia, arti dhe shoqëria.....	31

5.3	Qëndrime dhe vlera	33
5.4	Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve).	34
6	METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES	37
6.1	Roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale në mësimin e artit pamor.	37
6.2	Puna me nxënësit me nevoja te veçanta në lëndën e artit pamor.	38
6.3	Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e artit pamor	40
7	VLERËSIMI I NXËNËSVE	41
7.1	Llojet e vlerësimit në lëndën e artit pamor	41
7.2	Parime të rëndësishme të vlerësimit të nxënësit në lëndën e artit pamor	43
7.3	Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit, RN-ve.	43
8	BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE	45
8.1	Përdorimi i teknologjisë dhe burimeve digjitale	46
9	REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT	47
10	NDRYSHIMET PËRMBAJTJESORE	49

Përmbajtja e tabelave

Tabela 1. Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit.	11
Tabela 2: Kompetencat lëndore dhe rezultatet e të nxënit.....	18
Tabela 3: Orë të sugjeruara për çdo tematikë	21
Tabela 4. Qëndrimet dhe vlerat.....	33
Tabela 5. Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e RN-ve.....	34
Tabela 6. Shembull për nivelet e arritjes për vlerësimin e RN-ve	44

Përmbajtja e diagrameve

Diagrama 1. Përmbajtja e programi lëndor të artit pamor	8
Diagrama 2. Korniza konceptuale e lëndës së artit pamor.....	17
Diagrama 3 Shembull situate të nxëni dhe lidhja me elementet e programit	36

1 HYRJE

“Arti pamor” është një mënyrë për të krijuar dhe komunikuar nëpërmjet imazhit. Lënda e “Artit pamor” është një lëndë e veçantë dhe ka kërkesat e veta specifike të të mësuarit. Veprimtaritë e “Artit pamor” bëjnë të mundur që nxënësit të bëjnë lidhjen midis botës reale dhe imagjinare, të organizojnë dhe të shprehin vizualisht idetë, ndjenjat dhe eksperiencat nëpërmjet teknikave të larmishme artistike. Edukimi nëpërmjet “Artit pamor” siguron zhvillimin e krijimtarisë dhe përvojave personale nëpërmjet zbulimit, kërkimit, eksperimentimit, trillimit, vizatimit dhe përdorimit të një sërë mjeteve dhe teknikave. Kjo lëndë promovon vëzhgimin dhe ndihmon nxënësit të fitojnë ndjeshmëri për botën vizuale, hapësinore të prekshme dhe për eksperiencat estetike. Arti pamor ka të bëjë me materializimin e mendimit i cili shpreh një realitet social kulturor. Që në fillimet e njerëzimit, njerëzit e kanë përdorur artin si një mënyrë për të përcjellë botëkuptimin e tyre nëpërmjet imazhit, duke përdorur aftësi që kanë qenë të ndryshme në varësi të vendit, periudhës historike dhe kulturës. Prezenca e imazheve përgjatë shekujve tregon për rëndësinë e madhe që kanë njohuritë artistike për njeriun dhe që ato kanë zënë rrënjë në ndjeshmërinë, intuitën dhe imagjinatën e tij. Artistët gjithashtu kanë dhënë kontributin e tyre në zhvillimin e ideve dhe si rrjedhojë edhe të shoqërisë duke shprehur bindjet, vlerat dhe shqetësimet përmes veprave të tyre të artit.

Në artin pamor imazhi mund të marrë forma të ndryshme, në varësi të mjeteve dhe materialeve që përdoren për ta realizuar atë. Imazhi mund të jetë dy ose tre dimensional, abstrakt ose figurativ, dinamik ose statik, etj. Gjithashtu, ai krijohet duke përdorur teknika të ndryshme artistike. Përzgjedhja e materialeve dhe organizimi i gjuhës vizuale në një vepër varen nga mesazhi që ajo do të komunikojë. Edukimi, nëpërmjet lëndës së artit pamor, nxit zhvillimin e përgjithshëm të nxënësit dhe pasuron kulturën e tij/saj. Kjo lëndë i ndihmon nxënësit të deshifrojnë mesazhet pamore, të vëzhgojnë imazhet me një ndjeshmëri më të lartë, të ushtrojnë mendimin kritik.

Sot në kulturën edukative i kushtohet shumë rëndësi pranisë së imazhit, dhe në këtë drejtim artet pamore luajnë një rol themelor në zhvillimin social, ekonomik dhe artistik të nxënësve.

Programi i artit pamor mësohet përmes tematikave të *gjuhës dhe komunikimit artistik, teknikave dhe proceseve dhe historisë, artit dhe shoqërisë* dhe bazohet në tre kompetenca: *krijimi artistik, realizimi i punimit dhe vlerësimi i veprave të artit*.

2 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS

Qëllimi i mësimit të “Artit pamor” *në arsimin e mesëm të ulët* është të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësitë krijuese, komunikuese, të kuptojnë botën që i rrethon. Krijimtaria në art, kontribuon në formimin e një identiteti personal e të vetëbesimit dhe ndihmon në krijimin vetëdijes kulturore dhe ndjeshmërisë artistike. Nxënësit kanë mundësi të krijojnë imazhet e tyre, duke u përfshirë në procesin krijues, duke zbuluar mundësi të shumta të kombinimit të materialeve me gjuhën vizuale, për të komunikuar mendimin e tyre për një audiencë të caktuar. Në këtë klasë ata mësojnë të ushtrojnë mendimin kritik dhe të zhvillojnë ndjesitë e tyre estetike nëpërmjet vlerësimit jo vetëm të punëve të tyre dhe të shokëve/shoqeve, por edhe të veprave të artit, të objekteve tradicionale dhe imazheve të mediave të marra nga historia dhe trashëgimia kulturore e të tashmes dhe e të shkuarës. Nëpërmjet lëndës së artit pamor, nxënësit inkurajohen të bëjnë lidhjen e artit pamor me lëndët e tjera në kurrikul dhe ta shohin artin si një mundësi karriere. Synohet gjithashtu zhvillimi i aftësive sociale, bashkëpunimi në grup, përdorimi i teknologjisë, si dhe formimi i qëndrimeve pozitive dhe të qëndrueshme ndaj të nxënit gjatë gjithë jetës.

2.1 Objektivat e përgjithshme të artit pamor në arsimin e mesëm të ulët

Objektivat e përgjithshme që synohen të arrihen në përfundim të klasës së gjashtë kërkon që nxënësit:

- Të zhvillojnë aftësinë për të vëzhguar dhe analizuar botën përreth tyre, duke dalluar elementët pamorë si forma, ngjyra, vija dhe tekstura në objekte të ndryshme natyrore dhe të krijuara nga njeriu.
- Të shprehin lirshëm ndjenjat, idetë dhe përvojat personale përmes krijimtarisë pamore, duke përdorur teknika dhe materiale të ndryshme.
- Të përvetësojnë njohuritë bazë mbi elementët dhe parimet e artit pamor, dhe të mësojnë si t'i përdorin ato në mënyrë krijuese në punimet e tyre.
- Të zhvillojnë ndjeshmëri ndaj artit përmes veprave artistike, si pjesë e trashëgimisë kombëtare dhe botërore.


- Të eksperimentojnë me teknika të ndryshme si vizatimi, piktura, kolazhi apo punime tredimensionale, duke zhvilluar mendim kritik dhe imagjinatë krijuese.
- Të zhvillojnë aftësitë për të punuar si në mënyrë individuale edhe në grup, duke bashkëpunuar në realizimin e projekteve artistike.
- Të zhvillojnë aftësitë për të përdorur teknologjinë dhe mjetet digjitale në krijimin, përpunimin dhe paraqitjen e veprave artistike.
- Të zhvillojnë aftësitë për të lidhur artin pamor me lëndë të tjera (muzika, shkenca, historia dhe gjeografia) duke krijuar vepra artistike.
- Të shprehin emocionet dhe idetë përmes pjesëmarrjes aktive në veprimtari artistike, duke përdorur mjete dhe teknika të ndryshme krijuese.
- Të mësojnë ndërtimin e i qëndrimeve pozitive ndaj mësimin të artit pamor dhe përfshirjes në jetën kulturore.

3 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i Artit pamor synon të krijojë kushte të favorshme për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe, duke u mbështetur në situata të jetës reale dhe në kontekstin shkollor. Në thelb, ky program përqendrohet në formimin e nxënësve si individë të aftë për të kuptuar, interpretuar dhe zbatuar njohuritë artistike në mënyrë funksionale dhe të ndërgjegjshme në jetën e tyre të përditshme. Programi i lëndës së artit pamor në arsimin e mesëm të ulët përmban:

- a) *Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënësve që zhvillohen nëpërmjet lëndës së artit pamor.* Lënda e artit pamor kontribuon drejtpërdrejt në ndërtimin e kompetencave kyçe si dhe aftësive të shekullit 21-të si: të menduarin kritik dhe zgjidhjen e problemeve, aftësitë qytetare, aftësitë sociale, aftësitë digjitale etj. Përmes përmbajtjes së saj, artit pamor ndihmon në formimin e qytetarit të aftë për të menduar logjikisht, për të analizuar situata dhe për të marrë vendime në jetën e përditshme.
- b) *Temat ndërkurrikulare dhe zhvillimi i tyre nëpërmjet lëndës së artit pamor.* Programi i artit pamor ndërthur njohuritë dhe aftësitë e saj me temat ndërkurrikulare si: identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; qytetaria aktive dhe sipërmarrja; shëndeti mendor e fizik dhe siguria; zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore; teknologjia, shoqëria dhe media duke i lidhur konceptet artistike me situata konkrete që nxënësit përballen në jetën e tyre.

Diagrama 1. Përmbajtja e programi lëndor të artit pamor



- c) *Kompetencat e lëndës dhe rezultatet e të nxënësve.* Lënda e artit pamor synon të pajisë nxënësit me kompetenca që shkojnë përtej aftësive të riprodhimit mekanik të objekteve dhe dukurive të ndryshme, duke ofruar aftësi krijuese mbështetur te zbulimi, kuptimi dhe analiza e

strukturuar. Në këtë mënyrë arti pamor nuk është vetëm një disiplinë artistike, por një mjet i fuqishëm për të zhvilluar aftësi kyçe të shekullit XXI. Ai e përgatit nxënësin për të qenë *krijues, bashkëpunues, komunikues efektiv dhe qytetar aktiv* në një botë në zhvillim të vazhdueshëm. Aftësitë kyçe të shekullit XXI, janë një grup kompetencash që i ndihmojnë individët të jenë të suksesshëm në një botë që ndryshon me shpejtësi, të drejtuar nga teknologjia, informacioni dhe globalizimi. Lënda e artit pamor, në mënyrë të natyrshme, kontribuon fuqishëm në zhvillimin e këtyre aftësive.

- d) *Përmbajtja mësimore dhe rezultatet e të nxënit.* Në këtë rubrikë përshkruhet koha e dedikuar (numri i orëve mësimore) të klasës së gjashtë për çdo tematikë, duke ofruar hapësirë për punë individuale, në grup dhe për projekte; tematikat e lëndës dhe përshkrimi i përmbledhur i tyre; njohuritë kryesore, aftësitë për secilën tematikë dhe qëndrimet që demonstroi nxënësi.
- e) *Metodologjia e mësimdhënies.* Në lëndën e artit pamor është e rëndësishme t'i kushtohet një vëmendje e madhe përdorimit të metodave interaktive, teknikave të menduarit kritik dhe krijues, zgjidhjes artistike dhe bashkëpunimit. Puna me projekte të integruara dhe detyra artistike janë në fokus të zhvillimit të lëndës. Përshtatja e mësimi për nxënës me nevoja të veçanta dhe mbështetja e talentëve në lëndën e artit pamor nxit kuriozitetin për lëndën. Në këtë rubrikë do të ketë edhe disa shembuj veprimtarish për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.
- f) *Vlerësimi i nxënësve është një tjetër rubrikë,* e cila përshkruan në mënyrë të përmbledhur llojet e vlerësimit të nxënësit, shembuj të instrumenteve të vlerësimit, vlerësimin si metodologji të nxëni. Gjithashtu në këtë rubrikë do të ketë edhe shembuj të niveleve të arritjes së rezultateve të të nxënit.
- g) *Burimet dhe materialet didaktike* që mund të përdoren në lëndën e artit pamor. Njohja me konceptet pamore, mjetet artistike dhe veprat e artit të sjella nga burime të ndryshme dhe materiale didaktike të demonstruara me mjete konkrete.
- a) *Rekomandime për zbatimin e programit.* Në këtë rubrikë do të ketë disa rekomandime për përdoruesit e programit lëndor siç janë: nxënësit, mësuesit, vlerësuesit e jashtëm të cilësisë, prindërit.
- h) *Ndryshimet përmbajtjesore.* Në këtë rubrikë do të përshkruhen përditësimet kryesore në përmbajtjen lëndore.

4 KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA E ARTIT PAMOR

4.1 Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit

Zhvillimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies kërkon që mësuesi të sigurojë një lidhje të qëndrueshme dhe funksionale midis kompetencave kyç dhe atyre të lëndës, sipas klasave të arsimit të mesëm të ulët. Kjo kërkon një planifikim të kujdesshëm të situatave të të nxënit, si dhe përzgjedhjen e metodave, mjeteve dhe burimeve të përshtatshme që nxisin angazhimin, reflektimin dhe zbatimin praktik të njohurive. Arti pamor nuk është vetëm një disiplinë artistike, por një mjet i fuqishëm për të zhvilluar aftësi kyçe të shekullit XXI. Ai e përgatit nxënësin për të qenë *krijues, bashkëpunues, komunikues efektiv dhe qytetar aktiv* në një botë në zhvillim të vazhdueshëm. Aftësitë kyçe të shekullit XXI, janë një grup kompetencash që i ndihmojnë individët të jenë të suksesshëm në një botë që ndryshon me shpejtësi, të drejtuar nga teknologjia, informacioni dhe globalizimi. Lënda e artit pamor, në mënyrë të natyrshme, kontribuon fuqishëm në zhvillimin e këtyre aftësive.

- **Kreativiteti**, ku arti pamor inkurajon dhe nxit krijimtarinë përmes gjuhës artistike, përdorimit të teknikave dhe veprave të artit. Nxënësit mësojnë të shprehin veten në mënyrë unike dhe të zhvillojnë ide origjinale.
- **Bashkëpunimi**, ku arti pamor nxit nxënësit të punojnë në grup si p.sh.: në projekte të përbashkëta, ku secili ka një rol të rëndësishëm. Kështu ju jepet mundësia që ata të punojnë në grup, të ndajnë dhe të kuptojnë përgjegjësitë.
- **Komunikimi**, ku arti pamor si një formë universale komunikimi – përçon ndjenja, mesazhe dhe histori. Gjithashtu, diskutimi mbi artin pamor ndihmon zhvillimin e të folurit dhe të shkruarit.
- **Mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve**, ku arti pamor inkurajon dhe nxit nxënësit në analizimin e veprave artistike, zhvillon aftësitë e vendimmarrjes gjatë krijimit dhe zgjidhja e sfidave teknike ndihmojnë në zhvillimin e mendimit analitik.
- **Aftësitë teknologjike**, ku arti pamor inkurajon dhe nxit përdorimin e programeve të ndryshme krijuese, që ofrojnë mjete dhe mënyra novatore në krijim, gjurmimin dhe shpërndarjen e informacionit artistik duke zhvilluar aftësitë digjitale.

- **Ndërgjegjësimi global dhe kompetencat kulturore**, ku arti pamor jep mundësinë njohjen dhe kuptimin e kulturave të ndryshme në klasë. Mësimi i artit pamor i ndihmon nxënësit të jenë më të hapur dhe të kuptojnë diversitetin kulturor.
- **Aftësitë për mësim gjatë gjithë jetës**, ku arti pamor kërkon përkushtim, durim dhe disiplinë – vlera që ndihmojnë në formimin e një qëndrimi pozitiv ndaj të nxënës të vazhdueshëm.

Kompetenca kuptohet sot si një ndërthurje e balancuar mes njohurive, aftësive, qëndrimeve, vlerave dhe mendimit kritik, që mundësojnë nxënësin të përballë me situata reale dhe komplekse në mënyrë efektive dhe të pavarur. Qasja e mësimdhënies e bazuar në kompetenca e zhvendos fokusin nga përvetësimi pasiv i përmbajtjes lëndore (me mësuesin si qendër të procesit) drejt formimit të aftësive që ndihmojnë nxënësin të kuptojë, të zbatojë dhe të transferojë njohuritë në situata të reja dhe jetësore, duke u vendosur vetë nxënësi në qendër të procesit. Rezultatet e të nxënës për kompetencat kyç që mund të zhvillojë nxënësi në klasën e gjashtë në lëndën e artit pamor mund të përmbledhen si më poshtë:

Tabela 1. Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënës.

Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare	Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja
<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhën amtare, nxënësi:</i> - përshtat komunikimin me situatat dhe qëllimet që ka arti pamor; - kërkon, mbledh dhe përpunon informacione mbi artin pamor me mjete ndihmëse; - merr pjesë në biseda për tema mësimore në art pamor; - komunikon për përvojat e veta në krijim duke përdorur fjalor të pasur; - analizon vepra arti dhe lidh përmbajtjen me tema sociale ose personale; - shpreh opinione mbi vepra të ndryshme arti dhe evente kulturore;	<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhë të huaj, nxënësi:</i> - merr pjesë në biseda të thjeshta mbi artin pamor, duke bërë pyetje dhe dhënë përgjigje; - transmeton saktë informacionin artistik në forma të ndryshme; - mbledh informacione të ndryshme mbi vepra të artit, artistë apo elemente të trashëgimisë në një ose më shumë gjuhë të huaja;

- prezanton projekte në art pamor individualisht ose në grup përmes komunikimit verbal dhe elektronik; - analizon dhe përdor koncepte të reja të artit pamor në kontekste të ndryshme krijuese.	- kupton tekste të thjeshta dhe arrin të ndjekë temat kryesore të tyre; - krahason informacionin kulturor nga vende të ndryshme; - mbështetës në diskutime dhe ndihmon për të kontribuar.
Kompetenca në STEM (matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri)	Kompetenca digjitale
<i>Për të dëshmuar kompetencat në STEM, shkencë, teknologji dhe inxhinieri, nxënësi:</i> - lidh koncepte shkencore nga lëndët e tjera me artin pamor p.sh.: (format gjeometrike dhe natyrore, ekuilibri, ngjyrat, etj.); - analizon fenomene natyrore si pjesë e kërkimit artistik; - paraqet argumente për problemet mbi artin pamor lidhur me shkencat; - përdor informacionin për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve në procese të ndryshme krijuese, duke argumentuar ato; - propozon dhe planifikon projekte me tematika nga arti pamor, duke ndjekur rrugën e duhur si: qëllime, aktivitete dhe burime të ndryshme; - përdor shembuj nga jeta e përditshme për të krijuar në art pamor.	<i>Për të dëshmuar kompetencën digjitale, nxënësi:</i> - përdor programe digjitale që ofrojnë mundësi të ndryshme shprehëse për krijuar; - krijon duke përdorur mjete digjitale që ofrojnë forma të ndryshme shprehëse; - bashkëpunon me moshatarët duke përdorur teknologjinë për zgjidhjen e problemeve; - përdor aftësitë e mendimit kritik dhe krijues për të planifikuar projekte me tematika të ndryshme në artin pamor;

Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit	Kompetenca qytetare
<i>Për të dëshmuar kompetencën personale, shoqërore dhe të nxënies, nxënësi:</i> - identifikon dhe përmirëson përparësitë dhe dobësitë personale ndaj njohurive dhe aftësive pamore; - organizon, fokusohet në të nxënit, vendos qëllime dhe vlerëson punën e tij në aspekte të ndryshme të proceseve mësimore; - motivon dhe vlerëson veten, punon në mënyrë të pavarur dhe në grup në detyra apo proceseve të ndryshme në art pamor; - shpreh dëshirë për të nxënit gjatë gjithë jetës dhe bashkëpunon në mënyrë konstruktive; - reflekton për rritjen personale përmes pjesëmarrjes në aktivitete të artit pamor; - vlerëson aftësitë e bashkëmoshatarëve në art pamor dhe jep kontribut konstruktiv në grup; - zhvillon ndjenjën e përkatësisë përmes projekteve artistike në shkollë.	<i>Për të dëshmuar kompetencën qytetare, nxënësi:</i> - tregon solidaritet në zgjidhjen e problemeve në shkollë, komunitet e më gjerë; - vlerëson diversitetin kulturor me tolerancë dhe respekt; - demonstroi vlerat e të drejtave të njeriut, si respekti për dinjitetin personal dhe lufta kundër diskriminimit; - menaxhon dhe zgjidh konfliktet në mënyrë konstruktive dhe paanshme; - angazhohet në aktivitete artistike që mbështesin kauza sociale ose ditë kombëtare. - zhvillon ndjeshmëri ndaj temave të drejtësisë dhe barazisë në art pamor. - kupton rolin e artit në ndërtimin e bashkësive dhe identiteteve kolektive.
Kompetenca e sipërmarrjes	Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore
<i>Për të dëshmuar kompetencën e sipërmarrjes, nxënësi:</i>	<i>Për të dëshmuar kompetencën për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, nxënësi:</i>

- përdor imagjinatën për procese krijuese dhe novatore përmes njohurive pamore; - planifikon projekte dhe organizon punën me tema të ndryshëm pamore; - punon në mënyrë të pavarur dhe bashkëpunon me të tjerët në detyra të ndryshme të artit pamor; - vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grup për zhvillimin e komunitetit; - ndërmer aktivitete për zgjidhjen e problemeve shoqërore (koncerte, ekspozita, etj.); - planifikon aktivitete artistike shkollore në mënyrë të organizuar; - bashkëpunon në grup për të realizuar projekte artistike me përgjegjësi; - merr rolin e udhëheqësit në një projekt në art pamor.	- shpreh idetë në krijimet e tij nëpërmjet përdorimit të gjuhës artistike; - përmirëson aftësitë e veta personale në lidhje me përdorimin e teknikave të larmishme artistike; - identifikon mundësi për të shprehur vlera personale, sociale nëpërmjet arteve; - analizon ndikimin e artit pamor në jetën e tij, në komunitet e më gjerë; - krahason vepra arti dhe elemente të trashëgimisë nga kultura të ndryshme; - përdor tema në art pamor që pasqyrojnë vlerat dhe përvojat personale; - angazhohet në procese krijuese, si individualisht ashtu dhe kolektivisht.
---	---

4.2 Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e artit pamor

Integrimi i temave ndërkurrikulare me artin pamor në arsimin e mesëm të ulët u mundëson nxënësve të kuptojnë më thellë lidhjet ndërmjet artit dhe jetës reale, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësi analitike, mendim kritik, argumentim dhe zgjidhje problemesh. Këto tema përforcojnë përdorimin e artit si mjet për interpretimin e të dhënave, planifikimin, marrjen e vendimeve dhe vlerësimin e situatave të ndryshme shoqërore, kulturore dhe shkencore.

- *Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.* Arti pamor i ofron mundësi nxënësit për zhvillimin e ndjenjës së *identitetit kombëtar, njohjes dhe respektit ndaj kulturave të ndryshme*. Përmes zhvillimit të kësaj teme lënda e artit pamor kërkon të zhvillojë ndjenjën e identitetit kombëtar përmes njohjes së elementeve të trashëgimisë kulturore shqiptare si veshjet, arkitektura, objekte etnografikë, etj. Nxënësit njihen me veprat e artit dhe autorë shqiptarë të periudhave të ndryshme historike e po ashtu me vepra dhe artistë nga bota, duke zhvilluar ndjenjën e përkatësisë dhe respektin për larminë kulturore. Kjo tematikë mundëson organizimin e aktiviteteve artistike - kulturore si: “Trashëgimia jonë kulturore”, “Java Ndërkulturore”, etj., ku mund të prezantohen punimet e nxënësve në ekspozita kolektive.
- *Qytetaria aktive dhe sipërmarrja.* Në këtë temë, arti pamor luan rol të rëndësishëm sepse krijon mundësi që nxënësi të mësojë jo vetëm për artin, por edhe për rolin e tyre si qytetarë të angazhuar dhe krijues në komunitet. Duke qenë se arti pamor ka qenë gjithmonë një formë shprehjeje për çështje sociale, politike dhe komunitare, nxënësi analizon vepra dhe krijime personale që përcjellin mesazhe të drejta qytetare, si: promovimi i paqes, të drejtat e njeriut, barazinë apo mbrojtjen e mjedisit etj. Nxënësi krijon vetë *punime që përçojnë mesazhe sociale*, duke u angazhuar në diskutime dhe reflektime mbi realitetin e tyre. Për realizimin e kësaj tematike mund organizohen ekspozita me tema sociale (si barazia gjinore, ndihmë për fëmijët në nevojë apo për të moshuarit, mjedisi, etj.). Ndërsa në lidhje me sipërmarrjen mund të trajtohen tema si: *si të menaxhosh një grup projekt artistik, apo një ekspozitë*. Ndërsa në lidhje me sipërmarrjen mund të trajtohen tema si: menaxhimi i një galerie art, roli i teknologjisë në promovimin shitjen e veprave të artit dhe krijimin e projekteve fitimprurëse.
- *Shëndeti mendor, fizik dhe siguria.* Nëpërmjet Artit pamor, krijohen mundësi të mira për të edukuar nxënësin por edhe duke ndikuar pozitivisht në mirëqenien emocionale, fizike dhe sociale të tyre. Arti ndihmon në shprehjen emocionale, reduktimin e stresit dhe nxit një

mendje të shëndetshme. Nxënësi vëzhgon vepra të ndryshme arti, dizajni dhe objekte të trashëgimisë kulturore duke krijuar albume të klasifikuara duke zhvilluar kështu ndjenjën e përqendrimit dhe vetëdijen emocionale. Nxënësi realizon postera me mesazhe motivuese për kujdesin ndaj vetes, emocioneve dhe trupit ose krijimi i artit që pasqyron ndjesitë personale. Gjithashtu nxënësit mësojnë të përdorin me kujdes mjete të ndryshme gjatë realizimit të punimit, për të krijuar sigurinë e tyre dhe të shokëve në punë.

- *Zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore.* Lënda e Arti pamor ndihmon në edukimin mjedisor duke inkurajuar riciklimin, ripërdorimin dhe reflektimin mbi ndikimin e njeriut në natyrë përmes krijimtarisë vizuale. Organizimi i një aktiviteti ose ekspozite me përdorimin e materialeve të ricikluara duke krijuar objekte artistike që përcjellin mesazhe për mbrojtjen e natyrës.
- *Teknologjia, shoqëria dhe media.* Arti pamor luan një rol të rëndësishëm për të zhvilluar te nxënësit aftësi kritike, kreative dhe digjitale në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur përmes teknologjisë. Nxënësit përdorin mjete digjitale si aplikacionet për vizatim (p.sh., Photoshop, Canva, Procreate) për të krijuar pamje vizuale që pasqyrojnë tema të ndryshme shoqërore, kulturore ose personale.
- Përmes përdorimit të teknologjisë, nxënësit mund të krijojnë projekte që lidhin artin dhe lëndë të tjera, duke krijuar postera, video dhe grafikë që pasqyrojnë mesazhe edukative.

4.3 Kompetencat e lëndës së artit pamor dhe rezultatet e të nxënës

Bazuar në këtë kurrikul, lënda e artit pamor synon të përmbushë tri kompetenca, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe që arrihen nëpërmjet tri tematikave kryesore. Këto kompetenca zbërthehen në rezultate të nxënës për secilën klasë.

Diagrama 2. Korniza konceptuale e lëndës së artit pamor




Tabela 2: Kompetencat lëndore dhe rezultatet e të nxënës

Kompetencat lëndore	Përshkrimi i kompetencave	Rezultatet e të nxënës për kompetencat për klasën e gjashtë
<i>Krijimi artistik</i>	Nxënësi përmes kësaj kompetence zhvillon aftësitë krijuese përmes mjeteve të artit pamor, duke përdorur imagjinatën, përvojat personale dhe ndikimet kulturore. Kjo kompetencë ndihmon nxënësin të eksperimentojë me forma, ngjyra, tekstura dhe përbërje vizuale për të shprehur ndjenja, mendime ose mesazhe konkrete.	Nxënësi: ✓ zbulon elementët e gjuhës vizuale në mënyrë personale dhe i përdor për të realizuar idetë e veta përmes imazheve; ✓ përdor me kompetencë hapat e procesit krijues që nga stimuli, ideja dhe realizimi nëpërmjet përzgjedhjes së teknikave të duhura artistike; ✓ eksperimenton për të personalizuar tema e subjekte të ndryshme; ✓ përdori qëllimshëm elemente të gjuhës artistike, e cila është një pjesë shumë e rëndësishme e procesit krijues; ✓ përdor gjuhën pamore dhe komunikimin e ideve origjinale; ✓ zbulon ide të reja, përdor burime të ndryshme informacioni, bën skica dhe përcakton qëllimin krijues.
<i>Realizimi i punimit</i>	Nxënësi, përmes kësaj kompetence, zhvillon aftësitë për të krijuar punime artistike, duke përdorur mjete dhe materiale të ndryshme dhe duke shprehur idetë e tij në mënyrë krijuese.	Nxënësi: ✓ krijon punë dy dhe tre-dimensionale në art dhe dizajn nëpërmjet përdorimit të teknikave të larmishme artistike; ✓ zbulon mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, tradicionale dhe digjitale, eksperimenton dhe i përdor me kompetencë në realizimin e punimit;

	Kjo kompetencë e ndihmon nxënësin të zhvillojë krijimtarinë dhe aftësitë praktike përmes artit, duke mësuar të shprehë idetë e tij në mënyrë vizuale.	✓ eksperimenton me efektet e ndryshme të tyre për të realizuar idenë dhe për të dhënë mesazhin për një audiencë të caktuar; ✓ zhvillon aftësitë e tij për të organizuar gjuhën vizuale nëpërmjet teknikave të ndryshme artistike dhe ndan eksperiencat krijuese me të tjerët; ✓ përdor teknika të ndryshme artistike në realizimin e ideve origjinale; ✓ zbulon gjatë procesit krijues, mundësitë e shumta shprehëse procesit krijues që ofrojnë teknikat artistike dy dhe tre-dimensionale; ✓ përdor burime të ndryshme informacioni, eksperimenton dhe përcakton qëllimin krijues.
--	--	--

<i>Vlerësimi i veprave të artit</i>	Nxënësi, përmes kësaj kompetence, mëson të shikojë dhe të kuptojë vepra arti duke zhvilluar aftësinë për të vëzhguar, analizuar dhe shprehur mendimin e tij për përmbajtjen, mesazhin dhe elementët artistikë. Kjo kompetencë ndihmon nxënësin të kuptojë dhe vlerësojë veprat e artit, duke zhvilluar shijen estetike, mendimin kritik dhe respektin për krijimtarinë artistike.	Nxënësi: ✓ analizon dhe interpreton vepra të ndryshme arti dhe objekte të trashëgimisë kulturore në aspektin historik dhe social kulturor; ✓ komunikon emocionet dhe gjykimin e tij mbi vepra të ndryshme arti si dhe për punën e tij dhe të shokut; ✓ vlerëson aspektet e cilësisë simbolike dhe shprehëse të veprave të artit duke marrë parasysh kontekstin historik të tyre; ✓ përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar eksperiencën e tyre artistike dhe atë që kanë mësuar nga kjo eksperiencë; ✓ kupton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri, respekton opinione estetike dhe kritike të ndryshme dhe identifikon një sërë profesioneve që lidhen me artin pamor.
---	---	---

5 PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

5.1 Koha mësimore për secilën tematikë për klasën e gjashtë

Lënda e artit pamor zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 1 orë secila (45 min.), pra gjithsej 35 orë për secilën klasë. Programi i artit pamor specifikon peshën (orët e sugjeruara) e secilës tematikë për secilën klasë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore të përcaktuara në planin mësimor të arsimit bazë. Shpërndarja e orëve ka për qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në raport me orët totale vjetore.

Tabela 3: Orë të sugjeruara për çdo tematikë

Tematika	Gjuha dhe komunikimi artistik	Teknikat dhe proceset	Historia Arti dhe shoqëria	Gjithsej orë
Klasa e gjashtë	10	17	8	35 orë

5.2 Përmbajtja e lëndës sipas tematikave dhe përshkrimi i përmbledhur i tyre

Në programin e artit pamor për klasën e gjashtë janë paraqitur tematikat përmbajtjesore: Tematika I: Gjuha dhe komunikimi artistik, Tematika II: Teknika dhe procese artistike; Tematika III: Historia, arti dhe shoqëria. Këto tematika janë bazë për të ndërtuar njohuri, aftësi dhe qëndrime e vlera. Për secilën tematikë janë paraqitur njohuritë, aftësitë, që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me tematikat përkatëse, ndërkohë qëndrimet dhe vlerat që demonstroi nxënësi në lëndën e artit pamor përmbledhen për të gjitha tematikat.

Tematikat dhe renditja e tyre nuk presupozon që përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, duhet të zhvillohet e ndarë sipas tematikave dhe në këtë renditje. Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

KLASA E GJASHTË

5.2.1 Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik

Përshkrimi i tematikës: Përmbajtja e kësaj tematike mundëson që nxënësi të zbulojë elementët e gjuhës vizuale dhe t'i përdorë për të realizuar idetë e veta përmes imazheve. Të përdorë me kompetencë hapat e procesit krijues që nga stimuli, ideja dhe realizimi nëpërmjet përzgjedhjes së teknikave të duhura artistike. Procesi i eksperimentit është pjesë e rëndësishme e krijimit artistik pasi ndihmon në aftësimin e nxënësit për të personalizuar tema e subjekte të ndryshme. Personalizimi i temave, subjekteve dhe përdorimi i qëllimshëm i elementeve të gjuhës artistike është një pjesë shumë e rëndësishme e procesit krijues.

NJOHURITË	AFTËSITË
A. Shenja dhe pika: - Shenja grafike, shenja plastike, shenja piktorike, shenja arkitektonike. - Pika dhe efektet e saj. B. Vija: - Cilësitë e linjës.	A. Shenja dhe pika: Nxënësi demonstroi se: - Analizon veçoritë për llojet e shenjave në stile dhe teknika të ndryshme artistike; - Eksperimenton me lloje të ndryshme shenjash: shenja grafike, shenja piktorike, shenja plastike duke kuptuar rëndësinë e saj komunikuese; - Zhvillon kompozime kreative duke përdorur ritme të përsëritura me pika dhe shenja; B. Vija:

- Vija si mjet shprehës.

C. Forma dy-dimensionale:

- Format natyrore, format gjeometrike.

D. Ngjyrat :

- Perceptimi i ngjyrës.
- Ngjyrat parësore ,ngjyrat dytësore, ngjyrat e treta.

Nxënësi demonstiron se:

- Identifikon lloje të ndryshme vijash (të drejta, të lakuara, të thyera, spirale etj.) në natyrë dhe në art;
- Përdor cilësitë e ndryshme të vijës për qëllime të caktuara në krijimet e veta;
- Përdor mjete të ndryshme artistike si lapsi, stilolapsi, karboni, lapustila, rapidografi, etj., për të krijuar emocione të caktuara nëpërmjet vizatimeve me vijën;

C. Forma dy-dimensionale:

Nxënësi demonstiron se:

- Identifikon dhe emërton forma dy-dimensionale në objekte, ilustrime dhe në natyrë;
- Zhvillon një dekoracion përmes kombinimit të formave gjeometrike;
- Analizon format natyrore dhe ato gjeometrike në veprat e artit, duke kuptuar përdorimin dhe rëndësinë e tyre në kompozim;

D. Ngjyrat :

Nxënësi demonstiron se:

- Kupton zbërthimin e dritës së bardhë në spektrin e ngjyrave përmes prizmit;

- Ngjyrat e ngrohta, ngjyrat e ftohta. E. Tekstura : - Tekstura të ndryshme (natyrale dhe artificiale). F. Vëllimi: - Drita dhe hija (hija e objektit dhe hija e mbartur). G. Hapësira: - Llojet e hapësirës.	- Shpjegon funksionin e rrethit të ngjyrave si mjet për të kuptuar përzierjen e ngjyrave dhe ndjesinë e ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta; - Eksperimenton me kombinime ngjyrash për të krijuar kompozime të ndryshme; E. Tekstura : Nxënësi demonstroi se: - Dallon ndryshimin mes teksturave natyrore (si gjethe, lëvore, pupla) dhe atyre artificiale (si pllaka, plastikë, metal); - Identifikon shembuj të ndryshëm të teksturës në natyrë dhe i interpreton në krijim, mbi sipërfaqe dy dhe tre-dimensionale; F. Vëllimi: Nxënësi demonstroi se: - Identifikon hijen e objektit dhe hijen e mbartur në objekte reale, në imazhe të ndryshme dhe vepra arti; - Zhvillon kompozime me objekte që shfaqin qartë hijen e vet dhe hijen e mbartur përmes dritës; G. Hapësira: Nxënësi demonstroi se:
---	--

-Paraqitja e hapësirës në sipërfaqe dydimensionale. -Planet. H. Baraspesha: - Simetria dhe asimetria.	- Identifikon elementët që krijojnë ndjesinë e hapësirës në një vepër arti(si madhësia, mbivendosja, perspektiva, hija); - Zbaton teknika të thjeshta për të krijuar iluzionin e hapësirës në një sipërfaqe dy-dimensionale; H. Baraspesha: Nxënësi demonstroi se: - Identifikon simetrinë, asimetrinë dhe simetrinë rrethore në natyrë dhe në art; - Zbulon që asimetria është e kundërta e simetrisë dhe kupton rëndësinë e përdorimit të asimetrisë në veprat e artit dhe arkitekturë; - Eksperimenton me aksin e simetrisë dhe simetrinë rrethore në krijimet pamore, duke ndërtuar kompozime me materiale të ndryshme;
--	---

5.2.2 Tematika: Teknika dhe procese artistike

Përshkrimi i tematikës: Përmbajtja e kësaj tematike mundëson që nxënësi të krijojë punë dy dhe tre-dimensionale në art dhe dizajn nëpërmjet përdorimit të teknikave të larmishme artistike. Ai zbulon mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, eksperimenton dhe i përdor me kompetencë në realizimin e punimit. Një vend të rëndësishëm zë përzgjedhja e qëllimshme e teknikave artistike nga nxënësi, eksperimentimi me efektet e ndryshme të tyre për të realizuar idenë dhe për të dhënë mesazhin për një audiencë të caktuar. Gjithashtu ai zhvillon aftësitë e tij për të organizuar gjuhën vizuale nëpërmjet teknikave të ndryshme artistike dhe ndan eksperiencat krijuese me të tjerët.

NJOHURITË	AFTËSITË
A. Vizatimi : - Teknikat grafike: vizatimi me laps, karbon. B. Piktura: - Akwareli	A. Vizatimi : Nxënësi demonstroi se: - Eksperimenton dhe krijon me mjete dhe teknika të ndryshme artistike duke u mbështetur në natyrë, në mjedis, në eksperiencë personale të fantazia për të komunikuar ide; - Krijojnë duke përdorur karakteristikat shprehëse të mjeteve të vizatimit si: gradacionet tonale të lapsit dhe gomës, karbonit etj.; - Shfaq krijimin e imazheve tre-dimensionale mbi sipërfaqe dy-dimensionale. B. Piktura: Nxënësi demonstroi se:

C. Mozaiku:

- Monotipi
- Stampa me relief dhe gërryerje.

E. Fotografia:

- Zbaton teknikat bazë të akuarelit përdor ujë dhe ngjyrë në masa të përshtatshme dhe përzierje të thjeshta;
- Shpreh procesin dhe rezultatin, duke vlerësuar efektet e arritura në krijim me teknikën e akuarelit;

C. Mozaiku:

Nxënësi demonstroi se:

- Kupton konceptin e mozaikut si teknikë artistike që ndërtohet me copa të vogla materiali për të formuar një figurë apo kompozim.
- Përdor materiale të ndryshme (letër, gur të vegjël, fasule me ngjyra, ngjitëse etj.) për realizimin e mozaikut.

D. Stampimi:

Nxënësi demonstroi se:

- Kupton dallimin midis teknikave të stampimit: monotipi, stampa me relief dhe gërryerje.
- Eksperimenton me teknikën e monotipit në realizimin e imazhit dhe stampimit mbi sipërfaqe me tekstura të ndryshme.
- Krijon stampa me relief dhe nëpërmjet gërryerjes dhe stampon mbi sipërfaqe me teksturë të ndryshme.

E. Fotografia:

- Imazhe fotografike dokumentojnë historinë. -Aparati fotografik. F. Grafik dizajni dhe prezantimi: -Projekt artistik. G. Skulptura: - Modelimi me plastelinë, baltë, karta pesta. - Gdhendja mbi materiale të buta.	Nxënësi demonstroi se: - Zbulon që imazhi fotografik ndryshon nga imazhi artistik i pikturës apo vizatimit dhe është mënyra kryesore e komunikimit vizual e këtij shekulli. - Përdor një aparat të thjeshtë fotografik për një qëllim të caktuar, duke kompozuar saktë. F. Grafik dizajni dhe prezantimi: Nxënësi demonstroi se: - Kupton rolin e dizajnit grafik si formë komunikimi vizual përmes simboleve, ngjyrave, shkronjave dhe imazheve. - Përdor elementët bazë të artit pamor (linjë, formë, ngjyrë, kompozim) në funksion të dizajnit. - Eksperimenton me ide krijuese, skica dhe materiale të ndryshme për të arritur një rezultat përfundimtar funksional dhe artistik. G. Skulptura: Nxënësi demonstroi se: - Modelon forma të thjeshta skulpturore duke përdorur plastelinë, baltë ose karta pastë, sipas një ideje ose teme të caktuar.
---	--

H. Konstruksioni: -Konstruksioni në arkitekturë. - Materiale të ndryshme dhe të riciklueshme.	- Zbaton gdhendjen në materiale të buta (p.sh, sapun, bukë peshk), duke përdorur mjete të përshtatshme. H. konstruksioni: Nxënësi demonstroi se: - Kupton rëndësinë e formave ndërtimore dhe lidhjen mes funksionit dhe pamjes në një strukturë arkitektonike. - Identifikon elementët bazë arkitektonikë si: muret, dritaret, kolonat, harku etj. në objekte të thjeshta ndërtimi. - Ndërton një model të thjeshtë arkitektonik, duke përdorur materiale si karton, letër, shkopinj druri, etj.
---	---

5.2.3 Tematika: Historia, arti dhe shoqëria

Përshkrimi i tematikës: Përmbajtja e kësaj tematike mundëson që nxënësi të zhvillojë mendimin kritik dhe analizën. Në këtë tematikë nxënësi aftësohet të analizojë dhe interpretojë vepra të ndryshme arti dhe objekte të trashëgimisë kulturore në aspektin historik dhe social kulturor. Ai komunikon emocionet dhe gjykimin e tij mbi vepra të ndryshme arti si dhe për punën e tij dhe të shokut. Duke ju referuar historisë së artit dhe kulturës nxënësi, pasuron perceptimin për mjedisin që e rrethon duke e njohur më mirë atë. Nëpërmjet kësaj tematike nxënësi kupton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri, gjithashtu respekton opinione estetike dhe kritike të ndryshme.

NJOHURITË	AFTËSITË
A. Histori arti : - Vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme dhe objekte nga trashëgimia kulturore (prehistoria, arti egjiptian, arti grek, arti romak, qytetet antike në Shqipëri .)	A. Histori arti : Nxënësi demonstroi se: - Analizon, interpreton dhe vlerëson vepra arti, objekte të trashëgimisë kulturore shqiptare dhe periudha të ndryshme historike, në kontekstin historik dhe në kontekstin social kulturor. - Identifikon elementët e gjuhës vizuale, teknikën e përdorur, aspektet historike në një vepër arti. - Krijon punime të frymëzuara nga periudhat historike, si vizatime, simbole apo elementë dekorativë të stilizuar. - Përdor fjalorin e duhur si në gjuhën e folur ashtu edhe të shkruar për të komunikuar vlerësimin e tij.

B. Eksperienca artistike:

- Vizita në studiot e artistëve, punishtet e artizanëve të zonës. - Takime me artistë, dizajnë, artizanë, arkitektë etj.

C. Ekspozita dhe evente kulturore:

- Vizita në muze, (arkeologji, etnografi) galeri arti, qendra kulturore, site arkeologjike, objekte të trashëgimisë kulturore, etj.

- Ekspozita, projekte artistike në klasë, shkollë dhe komunitet.

- Zbulon eksperienca të ndryshme artistike dhe profesione që lidhen me artin pamor, nëpërmjet takimeve me artistë të ndryshëm si të ftuar në shkollë, nëpërmjet vizitave në vendin e tyre të punës, nëpërmjet informacionit që marrin gjatë orës së mësimi dhe informacionit të mbledhur nga burime të ndryshme informacioni.

- Viziton muze, galeri, qendrën kulturore, site arkeologjike, etj.

- Merr pjesë në ekspozita e projekte artistike në klasë, shkollë e komunitet.

- Prezanton informacionin e mbledhur rreth veprave të artit dhe autorëve të tyre.

- Prezanton informacionin e mbledhur rreth objekteve të artizanatit dhe trashëgimisë kulturore nëpërmjet përdorimit të teknologjisë.

5.3 Qëndrime dhe vlera

Në lëndën e artit pamor nxënësi demonstroi qëndrimet dhe vlerat të përmbledhura si më poshtë:

Tabela 4. Qëndrimet dhe vlerat

Qëndrime dhe vlera:
Nxënësi: - Zhvillon qëndrim pozitiv ndaj të mësuarit të artit pamor duke nxitur kureshtjen, dëshirën për të zbuluar dhe eksploruar vepra arti, dizajni dhe elemente të trashëgimisë kulturore. - Krijon vetëbesim dhe vetëvlerësim duke i bërë ata të ndihen të sigurt për aftësitë e tyre në artin pamor. - Zhvillon durimin dhe përqendrimin, vëmendjen dhe këmbënguljen gjatë procesit krijues. - Zhvillon disiplinë dhe respekt gjatë krijimit dhe realizimit të punimit individual dhe në grup. - Përfshihet aktivisht dhe mëson të marrë pjesë me dëshirë në veprimtaritë krijuese dhe bashkëpunuese në klasë dhe në shkollë. - Krijon ndjenjën e bashkëpunimit dhe të punës në grup, duke nxitur ndjesinë e përkatësisë dhe përgjegjësisë kolektive. - Stimulon imagjinatën për të shprehur ndjenjat në mënyrë artistike përmes krijimeve artistike. - Ndan kuptimin dhe emocionet duke zhvilluar ndjeshmërinë dhe empatinë me të tjerët. - Njeh kultura të ndryshme përmes artit pamor, duke respektuar traditat e ndryshme artistike dhe diversitetin kulturor. - Praktikohet në mënyrë të rregullt për të krijuar një vetë disiplinë dhe përkushtim, duke kuptuar rëndësinë e përpjekjes dhe ushtrimit të vazhdueshëm.

5.4 Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve).

Në këtë rubrikë paraqiten disa shembuj të veprimtarive që mund të përdoren nga mësuesi për përmbushjen e rezultateve të të nxënit në tematika të ndryshme.


Tabela 5. Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e RN-ve

REZULTAT TË NXËNI TË ORËS MËSIMORE	VEPRIMTARIA PRAKTIKE
SHEMBULLI	
Krijon një model të thjeshtë ndërtese duke përdorur <i>forma të thjeshta dhe materiale të lehta</i> .	Prezantimi i situatës Mësuesi prezanton disa shembuj të thjeshtë të ndërtesave dhe objekteve arkitekturore nga kultura të ndryshme (p.sh. një kullë, një urë, një shtëpi tradicionale). Diskutohet pyetja: Çfarë e bën një ndërtesë të fortë dhe të bukur njëkohësisht? Zgjedhja e materialeve. Nxënësit udhëzohen që në aktivitetin e sotëm do të krijojnë një ndërtim të thjeshtë dhe do të mësojnë rreth elementeve kryesore të arkitekturës: forma, qëndrueshmëria dhe funksioni. Përshkrimi praktik. Nxënësit, në grupe të vogla, përdorin materiale të thjeshta (karton, letër, shkopinj druri) për të ndërtuar një model të thjeshtë ndërtese. Ata përpiqen të përdorin forma të qëndrueshme dhe ta bëjnë ndërtimin sa më funksional dhe estetik.

	Prezantimi. Në klasë prezantohen ndërtesat e realizuara. P.sh. <i>“Zgjedhëm të përdorim karton, sepse është material i lehtë, i qëndrueshëm dhe i lehtë për t’u prerë e dhënë formë.”</i> Reflektimi. Mësuesi udhëzon nxënësit të reflektojnë përmes pyetjeve: ▪ Çfarë mësova për ndërtimin e një strukture të qëndrueshme? ▪ Cilat forma dhe ide funksionuan më mirë? ▪ Si lidhet puna jonë me punën e një arkitekti të vërtetë?
--	---

Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e artit pamor do të përshkruhen veprimtari praktike për përmbushjen e rezultateve të të nxënit sipas tematikave të lëndës

Diagrama 3 Shembull situatë të nxënë dhe lidhja me elementet e programit



6 METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Mësimdhënia dhe të nxënit efektiv përfshin një kombinim qasjesh, strategjish, metodash dhe teknikash që përdoren për të mbështetur të nxënit efektiv dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësve në mjediset mësimore. Këto strategji dhe metoda marrin parasysh dhe plotësojnë nevojat e të nxënit si dhe sigurojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësve në përzgjedhjen dhe shfrytëzimin e informacionit, duke nxitur përgjegjshmërinë vetjake, iniciativën, reflektimin, pavarësinë e gjykimit, vetëvlerësimin, bashkëpunimin dhe barazinë. Edukimi promovon disa metoda të nxëni të cilat janë: a) Të nxënit me në qendër nxënësin; b) Të nxënit që promovojnë kompetencat; c). të nxënit e diferencuar; d) të nxënit e integruar; dh) Përdorimi i teknologjisë digjitale; e) Mësimin e kombinuar; ë) Të nxënit e bazuar në projekte; f) Angazhimi aktiv; g) Zhvillimin e të menduarit kritik dhe zgjedhjes së problemeve; gj) Të nxënit në bashkëpunim; h) Të nxënit e bazuar në krijime etj.

6.1 Roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale në mësimin e artit pamor.

Zhvillimi i ndjeshmërisë estetike dhe emocionale përmes përjetimit pamor.

- *Nxënësit mësojnë të vlerësojnë artin pamor dhe ndikimin e tij në ndjenjat dhe përjetimet personale.*

Formimi i kulturës pamore përmes njohjes së historisë së artit, veprave të artistëve përfaqësues kombëtarë e botërorë.

- *Nxitja e vlerësimit për trashëgiminë në artet pamore shqiptare dhe të popujve të tjerë.*

Zhvillimi i aftësive për të krijuar, analizuar dhe interpretuar artin pamor.

- *Përdorimi i vëzhgimit të vetëdijshëm dhe analizës për të kuptuar përbërësit vizualë të veprës artistike.*

Zhvillimi i aftësive për shprehje dhe interpretim vizual përmes mjeteve dhe teknikave artistike.

- *Punimi në grup dhe individualisht; përdorimi i mjeteve dhe materialeve të thjeshta për të krijuar dhe realizuar vepra artistike.*

Nxitja e krijimtarisë pamore dhe shprehjes personale përmes eksplorimit dhe realizimit të veprave origjinale artistike.

- *Përfshirja e nxënësve në krijime të thjeshta pamore, duke përdorur vizatimin, ngjyrat dhe materiale të ndryshme për të shprehur ide dhe emocione.*

Forcimi i bashkëpunimit dhe komunikimit përmes aktiviteteve artistike pamore, në grup.

- *Puna krijuese në grupe për realizimin e veprave artistike që nxit bashkëpunimin, frymën e grupit dhe përgjegjësinë e përbashkët.*

Përvetësimi i njohurive teorike bazë të artit pamor.

- *Njohja e elementeve bazë të gjuhës pamore si linja, forma, ngjyra, tekstura, kompozimi dhe përdorimi i tyre në shprehjen artistike.*

Ndërtimi i qëndrimeve pozitive ndaj mësimi të artit pamor dhe përfshirjes në jetën kulturore.

- *Inkurajimi për pjesëmarrje në aktivitete artistike dhe vlerësimi i artit si pjesë e rëndësishme e jetës shoqërore.*

6.2 Puna me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e artit pamor.

Mësimi i artit pamor me fëmijët me nevoja të veçanta kërkon strategji të veçanta të mësimdhënies për fëmijët me nevoja të veçanta kërkon një qasje të personalizuar, të ndjeshme dhe të mbështetur në metoda fleksibël e kreative. Ja disa metoda mësimi të rekomanduara, të shoqëruara me strategji praktike që mund të zbatohen në klasë. Disa nga metodat dhe qasjet që mësuesi mund të zhvillojë në klasë për fëmijët me nevoja të veçanta janë:

- *Përshtatja e materialeve dhe mjeteve artistike:* Përdorimi i materialeve të thjeshta, të përshtatshme për aftësitë motorike të nxënësve (p.sh. bojëra të pastra, ngjyra me gishta, forma të mëdha dhe materiale të buta) mund t'i ndihmojë ata të shprehën pa pasur nevojë për teknika komplekse.

- *Mbështetje vizuale dhe udhëzime të qarta:* Përdorimi i udhëzimeve vizuale (si diagramet dhe ilustrimet) dhe udhëzimeve të thjeshta për proceset krijuese ndihmojnë fëmijët me nevoja të veçanta të kuptojnë më mirë dhe të ndjekin hapat e aktiviteteve artistike.
- *Puna me grupe të vogla dhe aktivitete të përbashkëta:* Kjo ndihmon në zhvillimin e aftësive sociale dhe komunikative, duke krijuar mundësi për të mësuar nëpërmjet bashkëpunimit dhe ndihmës nga shokët e klasës.
- *Përshtatja e kohës dhe hapësirës për krijimin:* Disa nxënës mund të kenë nevojë për më shumë kohë për të përfunduar aktivitetet artistike. Përshtatja e kohës dhe sigurimi i një hapësire të qetë dhe të paketë për krijimin mund t'i ndihmojë ata të fokusohen dhe të shprehen më lehtë.
- *Inkurajimi i përdorimit të teknologjisë:* Përdorimi i aplikacioneve dhe mjeteve digjitale që ndihmojnë në krijimin e artit (si p.sh. piktura digjitale, animacione, etj.) mund të jetë shumë i dobishëm për fëmijët që kanë nevoja të veçanta dhe që mund të kenë sfida në përdorimin e mjeteve tradicionale.
- *Përqendrimi në shprehjen personale dhe ndjeshmërinë emocionale:* Përdorimi i aktiviteteve që lejojnë nxënësit të shprehen në mënyrë të hapur dhe të lirë (p.sh. pikturë, vizatim, dhe krijim me materiale të ndryshme) i ndihmon ata të përfshihen emocionalisht dhe të zhvillojnë aftësi të forta për të shprehur vetveten.
- *Përqendrimi në procesin dhe jo në produktin përfundimtar:* Disa nxënës mund të ndihen të mbyllur ose të stresuar nga pritshmëritë për një rezultat përfundimtar. Ndaj, fokusi mund të vendoset tek procesi krijues dhe kënaqësia që vjen nga vetë akti i krijimit, duke nxitur një mjedis pa presion.

6.3 Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e artit pamor

Mësimi i artit pamor për fëmijët e talentuar kërkon strategji të veçanta të mësimdhënies:

- *Aktivitete të avancuara dhe sfiduese:* Aktivitetet që kërkojnë përdorimin e teknika të avancuara dhe materiale më të sofistikuara, duke sfiduar nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe të krijojnë vepra më komplekse.
- *Përfshirja e projekteve të hapura dhe eksperimentale:* Nxënësit inkurajohen të eksperimentojnë me teknika dhe materiale të ndryshme, pa pasur një rezultat të paracaktuar, duke inkurajuar kreativitetin dhe eksplorimin.
- *Krijimi i një portofoli artistik:* Nxënësit krijojnë një koleksion të veprave të tyre, duke reflektuar për progresin dhe zhvillimin e aftësive të tyre, dhe përdorin këtë portofol për të vlerësuar arritjet e tyre.
- *Shfrytëzimi i vizitave dhe aktiviteteve jashtë klasës:* Vizitat në muze, galeri dhe ekspozita arti mundësojnë që nxënësit të shohin punime të tjera artistike dhe të marrin frymëzim për projektet e tyre, duke u ekspozuar ndaj diversitetit të shprehjes artistike.
- *Përfshirja e artit digjital dhe multimedial:* Nxënësit përdorin teknologjinë digjitale dhe mjete multimediale për të krijuar art të avancuar, duke zhvilluar aftësi në krijimin e animacioneve, dizajnit grafik dhe artit digjital.

7 VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në mësimin e artit pamor, vlerësimi i nxënësve në arsimin e mesëm të ulët është pjesë shumë e rëndësishme e procesit mësimor dhe ndihmon mësuesin të kuptojë se sa mirë po i përvetësojnë nxënësit njohuritë dhe aftësitë që lidhen me kompetencat e kësaj lënde. Në lëndën e artit pamor qëllimi i vlerësimit nuk është vetëm vendosja e një note, por:

- t'i japë nxënësit mundësi të kuptojë progresin e tij, të mësojë nga gabimet duke reflektuar në përmirësimin e njohurive dhe aftësive, si dhe të motivohet për të ecur përpara;
- të ndihmojë mësuesin të kuptojë sa mirë nxënësit i kanë kuptuar konceptet dhe po i zbatojnë ato;
- të ndihmojë mësuesin të përmirësojë mënyrën e mësimdhënies;

7.1 Llojet e vlerësimit në lëndën e artit pamor

Vlerësimi diagnostikues (vlerësimi si proces të nxëni)

Ky lloj vlerësimi bëhet në fillim të vitit shkollor ose të një kapitulli të ri. Mësuesi zbulon njohuritë që nxënësi ka dhe identifikon çfarë ka nevojë të përsëritet ose të mësohet më mirë. Ky vlerësim ndihmon mësuesin të planifikojë më mirë mësimin, duke përshtatur ritmin dhe mënyrat e punës me nevojat e nxënësve.

Ky vlerësim mund të realizohet:

- ✓ me pyetje të thjeshta dhe të drejtpërdrejta;
- ✓ me ushtrime të shkurtra orientuese;
- ✓ me kuice të shkurtra;

- ✓ me lojëra ose biseda reflektuese,
- ✓ fisha vetëvlerësimi, etj.

Vlerësimi formues (vlerësimi i vazhduar, vlerësimi për të nxënë)

Ky vlerësim bëhet gjatë gjithë procesit mësimor, në çdo mësim, për të parë si po ecin nxënësit. Ai ndihmon nxënësit dhe mësuesin të kuptojnë nëse janë në rrugën e duhur dhe çfarë duhet përmirësuar në punën e tyre para se të arrijnë vlerësimin përmbljedhës ose përfundimtar.

Teknika të vlerësimit formues janë:

- ✓ vlerësimi i punës në grupe;
- ✓ vëzhgimi i angazhimit dhe pjesëmarrjes gjatë mësimi;
- ✓ detyrat e përditshme dhe projektet e vogla;
- ✓ vlerësimi i diskutimeve dhe argumentimi i zgjidhjeve;
- ✓ vlerësimi i përgjigjeve gjatë mësimi;
- ✓ vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga bashkëmoshatarët, etj.

Vlerësimi përmbljedhës (vlerësimi periodik, vlerësimi i të nxënë)

Ky vlerësim bëhet pas një periudhe mësimore, ose pas një kapitulli dhe mat atë që nxënësi ka arritur të mësojë. Mund të realizohet me punime artistike individuale, konkurse, detyra përmbljedhëse dhe projekte përmbyllëse. Kjo zakonisht shoqërohet me notë dhe ndihmon mësuesin, nxënësin dhe prindërit të kuptojnë progresin dhe arritjet.

7.2 Parime të rëndësishme të vlerësimit të nxënësit në lëndën e artit pamor

- Vlerësimi duhet të ndihmojë nxënësit të mësojnë më mirë, të kuptojnë dhe të reflektojnë mbi gabimet e tyre.
- Detyrat dhe pyetjet e vlerësimit duhet të matin aftësitë dhe njohuritë që nxënësit duhet të zhvillojnë sipas kompetencave pamore.
- Vlerësimi duhet të jetë i qartë dhe i drejtë për të gjithë nxënësit, pavarësisht aftësive të tyre.
- Vlerësimi duhet të inkurajojë nxënësit të besojnë në vetvete dhe të kuptojnë që gabimi është pjesë e të nxënësit.
- Mësuesi duhet të përdorë shumë forma vlerësimi, si: përgjigjet me gojë, ushtrimet, punën me materiale konkrete, projektet, vizatimet, punën në grup, detyrat e shtëpisë etj.
- Ky proces ndihmon që vlerësimi të bëhet një mjet i dobishëm dhe i kuptueshëm për të gjithë, jo vetëm një "kontroll" për nota, por një mënyrë për të ndihmuar nxënësit të rriten dhe të përmirësohen çdo ditë në mësimin e artit pamor.

7.3 Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënësit, RN-ve.

Në këtë rubrikë paraqiten disa shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënësit në tematika të ndryshme.

Mësuesi ndërton një sërë instrumentesh për vlerësimin e nxënësit në art pamor duke iu referuar specifikave të lëndës. ***Instrumentet e vlerësimit*** janë të domosdoshëm për të marrë informacion lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive pamore nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre. Vlerësimi i nxënësve në lëndën e **artit pamor** duhet të jetë **i matshëm**, duke përfshirë tregues jo vetëm për njohuritë teorike por edhe shkathtësitë praktike, vëzhgim pamor, krijimtarinë dhe sjelljen gjatë aktiviteteve artistike.

Tabela 6. Shembull për nivelet e arritjes për vlerësimin e RN-ve

Shembull:			
Rezultati i të nxënit (RN):): Nxënësi krijon një model të thjeshtë ndërtese duke përdorur <i>forma të thjeshta</i> dhe <i>materiale të lehta</i> .			
Niveli i arritjes: Shumë mirë	Niveli i arritjes: Mirë	Niveli i arritjes: Mjaftueshëm	Niveli i arritjes: Dobët
- Nxënësi zotëron aftësitë për të krijuar një model ndërtese të rregullt, të qëndrueshëm dhe krijues. Përdor në mënyrë të saktë forma të thjeshta dhe i kombinon ato me kujdes.	- Nxënësi demonstroi aftësi të mira në krijimin e një model ndërtese të qartë dhe mjaft të qëndrueshme, duke përdorur forma të thjeshta.	- Nxënësi realizon një model të thjeshtë ndërtese me ndihmë. Struktura nuk është shumë e qëndrueshme dhe nuk janë përdorur mirë format.	- Nxënësi ka vështirësi në krijimin e modelit. Struktura është e paqëndrueshme ose e papërfunduar.

8 BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE

Gjatë procesit mësimor në art pamor, përdorimi i burimeve dhe materialeve të ndryshme ndihmon në ndërtimin e një kuptimi të thellë dhe praktik të koncepteve pamore. Materialet konkrete, vizuale dhe teknologjike krijojnë mundësi që nxënësit të mësojnë në mënyrë aktive, duke prekur, parë dhe zbatuar njohuritë në situata reale. Mësuesi ka mundësinë të integrojë mjete të ndryshme për të bërë mësimin sa më të qartë dhe të aksesueshëm për të gjithë nxënësit, si:

- ✚ *materiale vizuale*: figura, tabela, fotografi, imazhe veprash arti, etj.;
- ✚ *objekte reale*: mjete të ndryshme artistike dhe objekte reale në lidhje me temën mësimore;
- ✚ *mjete teknologjike*: projektorë, kompjuterë, tableta, apo platforma mësimore online.

Gjatë shpjegimit, mësuesi përdor gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, fjali të shkurtra dhe një fjalor të përshtatur për moshën dhe nivelin e nxënësve. Ai/ajo zgjedh shembuj konkretë dhe ushtrime të personalizuar, duke siguruar mbështetje shtesë për nxënësit që kanë nevojë.

8.1 Përdorimi i teknologjisë dhe burimeve digjitale

Përdorimi i teknologjisë ndihmon në zhvillimin e aftësive digjitale që janë thelbësore në shekullin XXI. Arti pamor, nuk është vetëm art, por është edhe një mjet i fuqishëm edukimi që ndihmon në përgatitjen e individëve për sfidat dhe mundësitë e botës moderne. Integrimi i artit pamor dhe dizajnit me teknologjinë ka ndikuar në forma dhe mjete të reja të krijimit por edhe të përdorimit, shpërndarjes dhe të promovimit në shekullin XXI. Aftësitë teknologjike zhvillohen edhe në lëndën e artit pamor duke zhvilluar kompetencat lëndore në një dimension të ri.

Integrimi i teknologjisë në dhënien e informacionit dhe përdorimi i aplikacioneve dhe programeve ofrojnë mundësi për krijimtari dhe për ta bërë mësimin më tërheqës për nxënësit.

Disa platforma aplikative u mundësojnë nxënësve të krijojnë duke përdorur mjetet digjitale. Mësuesit gjithashtu mund të përdorin teknologji audio-vizuale për të bërë mësimet më tërheqëse dhe për të ndjekur progresin e nxënësve.

9 REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Hartimi i programit të lëndës së artit pamor bazohet në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, Kurrikulën Bërthamë, Planin Mësimor të Arsimit Bazë si dhe në rekomandimet më të fundit të Bashkimit Evropian për arsimin. Si i tillë ky dokument i shërben mësuesve, autorëve të teksteve mësimore, hartuesve të testeve kombëtare, vlerësuesve të jashtëm të cilësisë, prindërve, nxënësve. Në këtë rubrikë përshkruhen disa rekomandime për zbatuesit e programit në mënyrë që të zhvillohet me efektivitet programi i lëndës së artit pamor.

A. Rekomandime për mësuesit

- ✓ Të lidhin përmbajtjen e lëndës së artit pamor me fusha të tjera (gjeografi, gjuhë, histori, art pamor, edukatë qytetare, TIK, etj.) për të ndihmuar kuptimin e thelluar dhe zbatimin praktik të koncepteve dhe për të kuptuar profesione të ndryshme.
- ✓ Të krijojnë aktivitete praktike që e ndihmojnë nxënësin të kuptojë përdorimin e artit pamor në jetën e përditshme dhe lidhjen me profesione të ndryshme.
- ✓ Të planifikojnë mësimin duke respektuar ritmet dhe nevojat individuale të nxënësve me nevoja të veçanta dhe për fëmijët e talentuar.
- ✓ Të nxisin mjedisin bashkëpunues, të sigurt, ku nxënësit ndihen të vlerësuar dhe të mbështetur në zhvillimin socio - emocional.
- ✓ Të sigurojnë akses të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë ata nga pakicat kombëtare dhe grupe të marginalizuara.
- ✓ Të sigurojnë balancën mes përmbajtjes teorike dhe përdorimit praktik të muzikës (p.sh. sugjerohet 40% teori — 60% praktikë). Përdorimi praktik i artit pamor do të realizohet përgjatë çdo ore mësimore. Mësuesi është fleksibël që në varësi të kontekstit të ndryshojë këto përqindje.
- ✓ Të sigurojnë dhe të përdorin librat origjinal të mësuesit si pjesë e paketës së teksteve shkollore.
- ✓ Të sigurojnë dhe të përdorin udhëzuesit kurrikularë të lëndës së artit pamor.
- ✓ Të përdorin materialet burimore për zbatimin e programit.

B. Rekomandime për vlerësuesit e jashtëm

- ✓ Të vlerësojnë mësuesit për cilësinë e mësimdhënies në zbatim të programit dhe rubrikave të këtij programi.
- ✓ Të vlerësojnë mësuesit për përdorimin e situatave nga jeta reale në përvetësimin e koncepteve pamore.
- ✓ Të vlerësojnë përdorimin e niveleve të arritjes për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.
- ✓ Të vlerësojnë organizimin e punës në grupe dhe bashkëpunimin në veprimtaritë mësimore.
- ✓ Të vlerësojnë balancën mes përmbajtjes teorike dhe përdorimit praktik gjatë zhvillimit të orëve mësimore.
- ✓ Të nxisin mësuesit që të krijojnë mjedise të përshtatshme për personalizimin e të nxënit dhe për mbështetjen e diversitetit në klasë.
- ✓ Të vlerësojnë se si mësuesit promovojnë mirëqenien socio emocionale të nxënësve përmes mënyrës së komunikimit dhe aktiviteteve në orën e artit pamor.
- ✓ Të vlerësojnë që mësuesit garantojnë qasje të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë pakicat kombëtare dhe grupet vulnerabël.

C. Rekomandime për prindërit

- ✓ Të inkurajojnë fëmijët që të kuptojnë rëndësinë e artit pamor jo vetëm për notë, por për jetën e përditshme.
- ✓ Të bashkëpunojnë me shkollën për të ndihmuar fëmijët në pjesëmarrjen në projekte të lidhura me artin pamor.
- ✓ Të sigurojnë që fëmijët ndihen të mbështetur emocionalisht dhe që mësimi i artit pamor të zhvillohet në një atmosferë të qetë dhe motivuese për fëmijët e tyre.

D. Rekomandime për nxënësit

- ✓ Të marrin pjesë aktive në orët e artit pamor, duke kërkuar të kuptojnë përdorimin praktik të njohurive pamore.
- ✓ Të bashkëpunojnë me shokët dhe të mësojnë të zgjidhin probleme si në klasë ashtu edhe jashtë saj.
- ✓ Të jenë kureshtarë dhe të kërkojnë ndihmë kur hasin vështirësi, duke përfshirë edhe përdorimin e mjeteve digjitale dhe burimeve online.
- ✓ Të kuptojnë rëndësinë e artit pamor si bazë për profesione të ndryshme dhe të eksplorojnë interesat personale në këtë drejtim.

10 NDRYSHIMET PËRMBAJTJESORE

Në lëndën e artit pamor të klasës së gjashtë ka këto ndryshime përmbajtjesore

1. Vendosja e fokusit në situatat e veprimtarive praktike të të nxënit duke sugjeruar një ndarje 40% pjesa teorike dhe 60% pjesa praktike. Mësuesi është fleksibël që në varësi të kontekstit të ndryshojë këto përqindje.
2. Përditësimi i kompetencave kyçe, dhe i rezultateve të të nxënit të përshtatura për klasën e gjashtë.
3. Përditësimi i kompetencave lëndore dhe i rezultateve të të nxënit të përshtatura për klasën e gjashtë.
4. Përditësimi i pjesshëm i aftësive për realizimin e kompetencave të lëndës, në tematikat Gjuha dhe komunikimi – Teknika dhe procese – Historia, arti dhe shoqëria.
5. Përditësimi i disa temave në lidhje me tematikën “Historia, arti dhe shoqëria”. Përcaktimi në mënyrë kronologjike i temave të historisë së artit.
6. Përditësimi i temave ndërkurrikulare.
7. Përditësimi i metodologjisë me fokus të shtuar në zhvillimin e mendimit kritik, krijues zgjidhjen problemore si dhe duke përfshirë të nxënit e personalizuar, të nxënit socio emocional, përdorimin e teknologjisë etj.
8. Përditësimi i vlerësimit të nxënit bazuar në nivelet e arritjes sipas rezultateve të të nxënit.